




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. 01-108/14
Dep. 02	Prot. No. 13.01.2014
Nr. f. llog. 02	Data 13.01.2014
Broj. stranica 02	Str. 01
Nr. pages 02	Str. 01
PRISTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3564/13, për ztr. *Bajram Mustafa* – Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes “Iber Lepenci”, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Por, Zyrtari i lartë është i obliguar që të bëjë deklarinimin “rast për rast” të interesave private në situatat e shfaqjes së tij (Neni 13, i Ligjit Nr.04/L-051).

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-3564/13, për Zyrtarin e lartë, ztr. *Bajram Mustafa* – Anëtar i Bordit të Ndërmarrjes Publike “Iber Lepenci”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-02-3564/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrtimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit faktik.

Zyrtari i lartë *Bajram Mustafa* (Drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike “Iber Lepenci”) ushtron edhe funksionin si Koordinator i Planifikimit dhe Investimeve në Divizionin e Industrisë dhe Përpunimit në Ndërmarrjen “Trepça”, por kjo pozitë nuk cilësohet pozitë që ka rol vendimarrës për Ndërmarrjen e as që është në mesin e Zyrtarëve të lartë të kësaj Ndërmarrje.

Ushtrimi i këtyre funksioneve mund të sjell ndonjë situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”, por, në bazë të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit Neni 13 paragrafi 1, në këto situata Zyrtari është i obliguar që të bëjë deklarinimin paraprak, rast për rast të interesave të tij private.

Kjo është e rregulluar me Nenin 13, paragrafi 1 në të cilin shprehimisht thuhet: ” Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik, në bazë të njohurive të tij dhe me mirëbesim detyrohet që të bëjë vet deklarinimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtar i lartë, kur kjo kërkohej nga eprori ose nga institucioni mbikqyrës. Deklarimin si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohej të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.(Neni 13, paragrafi 2).

Vet deklarimi si rregullë bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar (Neni 13 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-051).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

